

Sindroma e foshnjeve të shkundura më pak se 1 vjeç



Mos e shkundni kurrë një foshnjë !



Shkundja e një fëmije mund të jetë shumë e rrezikshme për shëndetin e tij : kjo mund të shkaktojë dëmtime të rënda në tru, që rrezikojnë të mbetet i paaftë ose edhe të vdesë.

Ky është një problem për të gjithë.

Nervozizëm ose lodhje

Kur fëmija juaj qan, sigurohuni që ai të jetë mirë (shih « dosjen të qarat »).

Mund të përjetoni të qara të zgjatura ose të bërtitura të tepruara që janë të vështira për t'u kuptuar.

Qarjet janë gjithmonë stresuese për prindërit që kanë frikë se diçka është jashtë kontrollit të tyre. Një fëmijë i shëndetshëm mund të qajë 2 deri në 3 orë në ditë dhe të zgjohet shpesh gjatë natës.



E rëndësishme

Gjatë një momenti nervozizmi e rraskapitjeje, shkundja e foshnjes është reagim i dhunshëm që mund të ketë pasoja shumë të rënda në gjendjen shëndetësore të fëmijës suaj.

Nëse qarjet vazhdojnë dhe ju ndjeheni të shqetësuar, nervoz, të lodhur, të rraskapitur :

- Vendosni fëmijën tuaj rehatshëm në shtratin e tij
- Dilni nga dhoma
- Thirrni një person të besuar (familje, fqinj, miq...)
- Telefononi maminë, infermieren për fëmijë të vegjël, pediatri ose çojeni fëmijën tuaj në spital.

Të fiktit dhe të qarit me gulshe janë shumë mbresëlënëse.

Mbështeteni fëmijën tuaj kundrejt jush në pozicion vertikal për ta qetësuar. Në rast urgjence, telefononi 144.



Programme cantonal de promotion de la santé et de prévention primaire enfants (0-4 ans) - parents



Section VD ■ Ne ■ Ju
Fédération Suisse de Sages-femmes

